



Qendra e Gruas



Cooperazione per lo sviluppo
dei paesi emergenti

Titulli i projektit:

“Per nje memesi te sigurt: proces pilot ne mbeshtetje te grave dhe te sherbimeve baze ne qytetin e Shkodres-Shqiperi .”

Subjekti financues:

Regione Emilia Romagna & Comune di Forli

Subjekti ekzekutues:

COSPE

Partnere:

Qendra e Gruas “Hapa te Lehte”

Vendi i nderhyrjes:

Qyteti I Shkodres, Shqiperi

Permbledhja E Projektit:

Projekti eshte nje aksion per forcimin e sistemit social dhe shendetesor te sherbimeve ne qytetin e Shkodres per mbeshtetjen e memesis qe nga fillimi i shtatezanise dhe ne vitin e pare te jetes se femijes. Projekti do te perdore te gjithë eksperiencen dhe punen e kryer ne rrjet nga Qendra e Gruas “Hapa te Lehte”, partnere e ketij projekti, brenda tre lagjeve te lena pas dore te qytetit (Lagja Liria, Kiras e Mark Lulaj) gjithashtu edhe eksperiencen e meparshme te nje pune sociale mbi temat e shendetit seksual te gruas, qe i ka dhene mundesi COSPE-s dhe Qendres se Gruas qe te behen mbi keto problematika, ndermjetes dhe partnere te institucioneve lokale dhe te sherbimeve baze te qytetit te Shkodres. Projekti do te mund te mbeshtetet edhe ne bashkepunimin me Komunen Forli dhe me strukturat e saj sociale dhe shendetesore ne territor qe do te vihen ne dispozicion te projektit me objektivin e nxitjes se shkembimeve dhe partneritetit.

AKSIONI i drejtohet:

- ↪ Qendrave shendetesore te lagjeve
- ↪ Konsultoreve per shendetin e nenes dhe te femijes (struktura e nivelit te dyte)
- ↪ Maternitetit

⇒ Dhe nepermjet ketyre sherbimeve grupeve te grave ne lagjet e lena pas dore te qytetit.

Objektivat e pergjithshme:

- ⇒ Kontributi ne uljen e vdekshmerise foshnjore. Behet fjale per nje fenomen te pranishem qe eshte i lidhur me semundjet e nenave te padiagnostikuara gjate shtatzanise.
- ⇒ Nxitja e aksioneve te ndjeshmerise sociale ne lagjet me te rrezikuara te qytetit nga kufizimet sociale, mbi kujdesin per shendetin e grave gjate shtatezanise dhe te femijerise se heret.

Objektivi specifik:

- ⇒ Ngritja e kapaciteteve per te ofruar sherbime cilesore duke nxitur, ne nivele te ndryshme te sistemit te sherbimeve per memesine, nje ndryshim kulturor bashke me nje permiresim te sherbimeve.

Rezultate dhe aktivitete:

REZULTATI 1. Forcimi i qendrave shendetesore te lagjeve veçanerisht qendrat shendetesore te Perash, Kiras e Tre Heronjte (pika referimi ne lagjet ku do te nderhyhet: Iliria, Kiras, Mark Lulaj).

Aktiviteti 1.1. Perzgjedhja dhe marrja ne pune e tre operatoreve sociale per cdo qender shendetesore ku do te nderhyhet, ashtu sic eshte parashikuar ne planin e ri shendetesor kombetar qe do te hyje ne fuqi duke filluar nga viti 2006. Projekti do t'i paguaje keto figura sipas marreveshjes me Bashkine dhe me Departamentin e Shendetit baze ne Shkoder per 12 muaj, ne pritje qe te merren ne pune nga Bashkia. Figura e punonjeses sociale do te kete si detyre qe te informoje dhe te sensibilizojte drejtpersedrejti grate per t'i afruar, duke bashkepunuar me personelin shendetesor per te identifikuar ne nivel lagje grate ne rrezik si edhe te krijojne nje rrjet midis niveleve te ndryshme te sherbimeve: qendrave shendetesore, konsultoreve dhe maternitetit.

Aktiviteti 1.2. Sistemimi i hapësirave te brendshme te qendrave shendetesore dhe pergatitja e dokumentacionit. Me ane te projektit duke perdorur pak instrumenta mund te sistemohen kartelat per te realizuar nje arkiv. Ne te tre qendrat do te krijohen hapësira te rehatshme per mikpritjen e grave.

Aktiviteti 1.3. Mbeshtetje punes se operatoreve te qendrave shendetesore duke krijuar grupe pune aktive dhe reflektuese, brenda nje programi konkret me aksione baze dhe me takime mujore per gjithë kohezgatjen e projektit.

REZULTATI 2. Forcimi i kater konsultoreve per shendetin e nenes dhe te femijeve qe jane te pranishme ne qytet.

Aktiviteti 2.1. Fillimi dhe mbeshtetja e punes ne rrjet midis konsultoreve dhe qendrave shendetesore perkatese, duke perdorur si mediatore operatoret sociale te punesuara ne te tre qendrat, qe duhet, duke filluar nga njohja e grave ne lagje, te bejne te mundur ardhjen e grave ne keto qendra si edhe t'i mbeshtesin ato per nje pjesemarrje te rregullt. Operatoret sociale te te tre qendrave shendetesore do te mbeshtesin punen e mamive si per periudhen e shtatezanise ashtu edhe per ate pas lindjes. Çdo grua do te kete nje fletore ku do te shenohen analizat e bera, rezultatet, keshillat dhe kurat qe do te behen hap pas hapi.

Aktiviteti 2.2. Trainim per personelin e kater Konsultoreve mbi projektin, duke garantuar edhe dhenie te te rejave te fundit, sepse figurat shendetesore qe nuk jane mjeke, ne pjesen me te madhe te rasteve, nuk kane ndjekur kurse te rregullta formimi dhe aq me teper kurse per dhenie te

te rejave te fundit. Trainimi do te zgjase tre muaj me nje frekuence javore prej 4 oresh dhe ne total 32 ore dhe do te perfshije operatoret e te gjithë konsultoreve (9 operatore).

Aktiviteti 2.3. Permiresimi i hapësirave te te dy konsultoreve ne te cilat drejtohen lagjet ku do te nderhyhet nepermjet projektit.

REZULTATI 3. Forcimi i Spitalit te Maternitetit

Aktiviteti 3.1. Formimi i personelit obstetrik te maternitetit per rikuperimin dhe mbeshtetjen e nje profesionalizmi deri me sot te lene pas dore. Formimi do te perfshije te gjithë personelin obstetrik te maternitetit dhe do te kete nje kohezgjatje prej 3 muajsh me nje frekuence prej 6 oresh ne jave, gjithsej 48 ore.

Aktiviteti 3.2. Kurs parapergatitje per linde qe gruaja mund ta ndjeke bashke me nje person te besueshem qe do t'i jete prane dhe ne momentin e lindjes se vertete. Ne marreveshje me sherbimin e spitalit te maternitetit dhe me bashkepunimin e tyre kursi do te realizohet prane zyrave te Qendres se Gruas. Qendra e Gruas do te kontribuojë edhe nepermjet bashkepunimit me shoqata te tjera, nepermjet informacionit dhe komunikimit te nevojshem.

Aktiviteti 3.3. Pajisja e nje dhome per lindje dhe venia ne dispozicion e burimeve te nevojshme si per kursin ashtu edhe per momentin e lindjes duke parashikuar nje karrige jo obstetrike dhe mobilimi i nje dhome te maternitetit.

REZULTATI 4. Aktiviteti i animacionit territorial ne tre lagjet e nderhyrjes per t'i perfshire grate si edhe per t'i afruar ato prane sherbimeve te ofruara.

Aktiviteti 4.1. Aktivitetet e animacionit territorial do te realizohen nga Qendra e Gruas ne bashkepunim te ngushte me operatoret sociale te qendrave shendetesore dhe me perfaqesueset e lagjeve. Te gjitha aktivitetet do te kene te njeitin objektive ate te afrimit te grave prane sherbimeve dhe ate te nderimit te nje programi te perbashket parandalimi dhe kujdesi qe merr parasysh kerkesat reale te grave.

Aktiviteti 4.2. Monitorimi dhe vleresimi i vazhdueshem do te behet nepermjet formimit te nje komiteti pilot i perbere nga drejtuesit shendetesor, drejtuesit e maternitetit, pergjegjesja e sherbimeve sociale te maternitetit, Qendra e Gruas, operatoret sociale, tre mamite e qendrave dhe te konsultoreve si edhe pergjegjesja e mamive ne spital.

Qendra e Gruas do te beje nje monitorim te vazhdueshem per te garantuar zbatimin e projektit, analizat e veshtiresive, perdorimin e burimeve si edhe bashkeveprimin midis aktiviteve.

Perfituesit e drejtperdrejte do te jene personeli shendetesor i qendrave shendetesore, i konsultoreve, dhe i maternitetit ne qytetin e Shkodres, si edhe grupet e grave ne Lagjet Iliria, Kiras e Mark Lulaj te qytetit te Shkodres.

Perfituesit jo te drejtperdrejte. Nderhyrja e parashikuar nga ky projekt synon, qe nepermjet permiresimit te sherbimeve shendetesore baze, te sjelle perfitime per te gjithë popullsinë e Shkodres.